



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

PLANI I ZHVILLIMIT STRATEGJIK 2018-2024

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Janar 2019



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Plani i Zhvillimit Strategjik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike
është zhvilluar sipas strukturës së më poshtme:

1. Misioni dhe Strategjia e Departamentit të Shkencave Kompjuterike
2. Objektivat e Departamentit të Shkencave Kompjuterike
3. Vizioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike
4. Puna Kërkimore-Shkencore
5. Stafi akademik, ndihmës akademik, studentët në DSHK
6. Gjendja Aktuale në Departamentin e Shkencave Kompjuterike
7. Analiza SWOT e Departamentit të Shkencave Kompjuterike
8. Shërbimet ndaj të tretëve/komunitetit
9. Kuadri Strategjik
10. Plan Veprimi



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

Hyrje

Procesi i Planifikimi Strategjik nisi me një prezantim tek stafi akademik ku u thekësua qëllimi i Planit Strategjik dhe instrumentat për realizimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe vendimit Nr. 26, datë 08. 11. 2018 të Bordit të Administrimit i cili ka aprovuar Planin Strategjik të Universitetit "Ismael Qemali", për periudhën 2018-2024 si dhe Planin e Veprimit për implementimin e tij. Departamenti i Shkencave Kompjuterike, ngre grupin e punës për hartimin e Planit Strategjik 2018-2024 për periudhën gjashtëvjeçare si dhe të hartojë Planin e Detajuar të Veprimit sipas modelit të Planit të Veprimit të UV-së. Të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen në Departamentin e Shkencave Kompjuterike do të udhëhiqen nga ky dokument i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së stafit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike, përmes një analize të detajuar disa vjeçare ka përcaktuar nivelet e arritjeve të deritanishme në procesin mësimdhënies e kërkimit shkencor, vendosjen e prioriteteve në përputhje këto me kredon, misionin e vizionin e tij.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Departamenti i Shkencave Kompjuterike është krijuar në vitin 2007, fillimisht si Departamenti i Teknologjisë së Informacionit me VKM. 822, datë 05/12/2007, ndryshuar si Departamenti i Shkencave Kompjuterike në 2008. Ky Departament me stafin dhe studentët e tij ka krijuar një mjedis mjaft cilësor që nxit procesin e të mësuarit dhe të kërkimit shkencor. Prej vitit 2008-2010, degës "Teknologji Informacioni" iu shtuan edhe 3 degë të tjera: "Informatikë", "Shkenca Kompjuterike" dhe "Shkenca Kompjucionale", plani mësimor i së cilës u hartua nga një grup pune i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, nën ndikimin sidomos të eksperiencës së universiteteve amerikane. Po në këtë periudhë kemi hapjen e dy programeve të reja të studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike dhe Master Profesional në Mesuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë.

Hartuar nga Grupi i Punës i përbërë:

- 1. Dr. Eljona Proko**
- 2. Dr. Alketa Hyso**
- 3. Dr. Dezdemonë Gjylapi**
- 4. Dr. Roneda Muçaj**



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

1. Misioni dhe Strategjia e Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Misioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është të arrije përsosmërinë në krijimin dhe transmetimin e njohurive në Shkenca Kompjuterike për të nxitur zhvillimin intelektual dhe profesional të studenteve duke iu përgjigjur nevojave të shoqërisë, nëpërmjet zgjerimit dhe diversifikimit të fushave që departamenti ofron. Synojmë të kryejmë veprimtari kërkimore teorike, eksperimentale dhe aplikative në Shkenca Kompjuterike dhe fusha të tjera të lidhura me të, duke u bërë faktor në zhvillimin rajonal, nëpërmjet transferimit të teknologjive.

Misioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka për mision kryesor:

- a. të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;
- b. të ofrojë programe të studimeve në nivel Bachelor dhe Nivel Master;
- c. të zhvillojë punë shkencore në të gjithat e shkencave kompjuterike dhe informatikes që dhe të përgatisë specialistë dhe kerkuesë të rinj;
- d. të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese;
- e. të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimiti i lartë gjatë gjithë jetës;
- f. të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel rajonal dhe kombëtar;
- g. të ofrojë shërbime, në përputhje me misionin e tij;
- h. të mbështesë dhe realizojë aftësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkim shkencor.

Në zhvillim të misionit të tij Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka si objektiv të shoqërojë dhe të mbështesë studentët në mënyrë që ai të zhvillojë më së miri potencialitetin e tij. Të nxisë krijimin, transferimin dhe përparimin e dijes për t'ju përgjigjur nevojave për një formimimi të lartë bazuar në kërkimin shkencor në të mirë të shoqërisë.

Në realizimin e misionit të tij, persa i perket mesimdhënies Departamenti i Shkencave Kompjuterike vepron në respekt të të gjitha standarteve ndërkombëtare, Deklarates se Bolonjes dhe Kornizes Shqipëtare të Kualifikimit. Departamenti promovon zhvillimin e lirë të studimit, procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës, kombëtare dhe ndërkombëtare; hapjen ndaj komunitetit



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar; bashkëpunimin me administratën shtetërore; raportin e frytshëm bashkëpunues me ndërmarrjet dhe bizneset, me botën e punës dhe të profesioneve. Të sigurojë edukim cilësor në nivelin e studimeve bachelor dhe master, duke i pajisur studentët me koncepte teorike dhe praktike në disiplina të shkencave kompjuterike, afësimit nëpërmjet trajnimit në aplikimin e njohurive të fituara në zgjidhjen e problemeve reale, duke i pajisur me një avantazh kompetitiv në mjedisin global dinamik të punës dhe hedhur themelet për një karrierë cilësore profesionale afatgjatë.

Të zhvillojë kërkimin shkencor për të avancuar me të rejtat e shkencave kompjuterike dhe integrimin e rezultateve dhe novacioneve në disiplina të tjera shkencore.

Synojmë të kryejmë veprimtari kërkimore teorike, eksperimentale dhe aplikative në Shkenca Kompjuterike dhe fusha të tjera të lidhura me të, duke u bërë faktor në zhvillimin rajonal, nëpërmjet transferimit të teknologjive.

Strategjia e Departamentit të Shkencave Kompjuterike

- 1) Promovimi dhe përhapja e njohurive shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit
Departamenti i Shkencave Kompjuterike bën promovimin e programeve të studimit të ofruara nga departamenti pranë nxënësëve të gjimnazeve në rrethin e Vlorës.
Departamenti ynë është i përkushtuar për të siguruar përvoja arsimore e shkencore cilësore, në mënyrë që t'i aftësojë studentët e tij për të arritur një zhvillim të plotë intelektual, profesional e shoqëror. Ne pranojmë që secili student që bëhet pjesë e departamentit tonë duhet të arrijë në edukim një plotësim të kënaqshëm të vetvetes, në mënyrë që të japë kontribut të vlefshëm në profesionin e tij.
- 2) Mjetet e nevojshme për një karrierë të sukseshme për studentët dhe stafin
Kjo do të arrihet përmes aplikimit të metodave të avancuara në mësim dhe ndërlidhjes së fuqishme të teorisë me problemet praktike. Studentët do të kenë mundësi të angazhohen në zhvillimin e projekteve praktike inovative me qëllim të aplikimit të menjëhershëm në praktikë të teknikave dhe metodave teorike dhe të kreativitetit të tyre. Kjo do të garantojë një perspektivë më të madhe në zhvillimin dhe udhëheqjen e projekteve të mëdha e të vogla në çdo kompani të vendit dhe të huaj.



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

3) Rol udhëheqës në ekonominë lokale

Zhvillimi i teknologjisë ka sjellë dhe zhvillimin e arsimit në shërbim të një tregu pune që i përgjigjet kohës.

Një element tepër i rëndësishëm në operacionet e përditshme të sipërmarrjeve turistike është edhe teknologjia e informacionit që këto sipërmarrje përdorin në funksion të marketingut, shitjeve, rezervimeve etj. Vlora është një qytet me potencial të lartë në sektorin e turizmit.

Turizmi njihet si një nga industritë më të mëdha në botë në të cilën është përdorur teknologjia e informacionit. Fokusi i përfshirjes së e-biznesit në turizëm lidhet me aktivitetet e përbaljes me konsumatorët që kërkojnë shërbime turistike komplekse, duke filluar kryesisht me e-marketing dhe e-shitje. Studentët e diplomuar në Departamentin e Shkencave Kompjuterike janë dhe do të jenë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë lokale duke kontribuar me anë të kopetencave dhe aftësive të tyre.

4) Ndhimja në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit

Studentët e departamentit të Shkencave Kompjuterike me mbështetjen e stafit akademik kanë ofruar një ndihmesë dhe përkujdesje për fëmijët jetimë në drejtim të lehtësimit të vështirësive ekonomike, si dhe edukimit dhe arsimit të tyre, duke e konsideruar këtë si një ndihmëse modeste, por pozitive dhe shumë të rëndësishme jo vetëm për fëmijët jetimë, por edhe për të ardhmën e shoqërisë.

Departamenti është pjesë e Maratonës "Fundjavë ndryshe" që organizon Universiteti ynë tashmë si një traditë sportive në bashkëpunim me organizatën jofitimprurëse "Fundjavë ndryshe" për të ndihmuar familjet në nevojë.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

2. Objektivat e Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka përcaktuar si objektiva edukimi dhe kërkimi:

- Promovimin e kërkimit dhe studimeve të avancuara në fusha të ndryshme teorike dhe aplikative në Shkenca Kompjuterike dhe Informatikë si dhe në fusha multidisiplinare të lidhura me to.
- Promovimin e filozofisë të të mësuarit të studentëve që përgatiten për profesione specifike në shkenca kompjuterike, informatikë dhe teknologji informacioni.
- Të sigurojë një ambient kërkimi stimulus për individët të cilët të jenë drejtues në industri dhe akademi në aplikime të informatikës dhe zhvillimin e teknologjive të reja për të mirën e shoqërisë.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike duhet të karakterizohet nga:

- standart akademik i lartë në kërkim, edukim dhe shërbim
- mundësi të konsiderueshme zhvillimi
- përgjegjshmëri në të gjitha punimet akademike

3. Vizioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Vizioni i departamentit deri në vitin 2024 është:

- Të bëjë DSHK një departament me rol të rëndësishëm për gjithë Universitetin "Ismail Qemali" dhe partner kryesor në lidhje me edukimin dhe hulumtimin ndër-fakultetor dhe ndërdisiplinor të IT-së në bashkëpunim me departamentet e fakulteteve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- Të bëjë DSHK një nga departamentet më të mira të Shkencave Kompjuterike në Shqipëri.
- Të ofrojë programe në nivel Bachelor dhe programe në nivel Master me njohuri afatgjata dhe praktike duke i pajisur studentet me kompetenca që vlerësohen shumë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
- Të përqëndrohet në hulumtimet në disiplina kryesore të Shkencave Kompjuterike.
- Të zhvillojë aktivitete shkencor të larmishëm dhe të integruar me disiplina të tjera shkencore, duke siguruar një partneritet të lartë dhe funksional, jo vetëm brenda vendit,



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

por edhe me homologë europianë për të arritur ndërkombëtarizimin e departamentit. Të përfshijë studentët në projektet dhe skenare të kërkimit shkencor.

- Të sigurojë ekspertizë dhe shërbime ndaj të tretëve/komunitetit, duke u bërë faktor në jetën ekonomike dhe sociale të rajonit.
- Të motivojë dhe të mbështesë studentët për të qënë pjesë aktive e jetës sociale të rajonit, duke formuar jo vetëm profesionistë dhe kërkues të mirë, por dhe qytetar të denjë.

4. Puna Kërkimore-Shkencore

Departamenti i Shkencave Kompjuterike do të fokusohet në fushat e veprimtarisë kërkimore shkencore si më poshtë:

- Aplikim i teknologjive smart në funksion të "Smart University".
- Aplikim i teknologjive Data mining dhe machine learning në analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e njohurive.
- Zhvillim shërbimesh online në funksion të të tretëve.

Për të patur një punë akademike të cilësisë së lartë në përputhje me standartet europiane stafi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është angazhuar dhe do të vazhdoj të angazhohet duke marrë pjesë në konferenca shkencore të organizuara brenda apo jashtë vendit. Synojmë që punimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik të botohen në revista shkencore prestigjioze në Europë. Për të arritur objektivat Departamenti ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Kërkimit Shkencor për periudhën pesëvjeçare 2018-2022.

Për të arritur këto objektiva në lidhje me punën kërkimore synojmë:

- 1) Nxitje dhe mbështetje të punës kërkimore individuale të stafit në funksion të kualifikimit dhe të promovimit për marrjen e titujve akademik.
 - a. Gjithëpërfshirjen e stafit në punën kërkimore.
 - b. Mbështetje financiare për aktivitetin shkencor.
 - c. Nxitje e sfidave individuale dhe e punës në grup në kërkimin shkencor.
- 2) Zhvillimi i një kërkimi shkencor me rezultate të njohura kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

- a. NËPËRMJET botimeve të rezultateve të kërkimit në buletine shkencore universitare dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti.
 - b. Pjesëmarrje në konferenca, simpoziume, ëorkshop-e dhe seminare kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 3) Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të lidhura me fushat e interesit të departamentit.
- a. Aplikim projektesh në nivel ndërkombëtar pranë Erasmus+, Horizon 2020
 - b. Zhvillim i projekteve konkurruese për të përfitur nga fondet e UV për kërkimin shkencor.

Në vemendje dhe me prioritet të vecantë Departamenti i Shkencave Kompjuterike do të organizoj aktivitete shkencore që përfshijnë studentët dhe luajnë një rol në krijimin e kërkueseve dhe shkencëtarëve të ardhshëm.

Në kuadrin e aktiviteteve të zhvilluara në departament në të cilat edhe studentet kanë qenë aktorë të rëndësishëm përmendim si më poshtë:

1. Konferencën e parë shkencore ndërkombëtare. "First International Conference on New Research and Advances on Computer Science and Information Technology (NRA – CSIT)", 30 Qershor – 1 Korrik 2017.

Kjo konferencë u organizua nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike të Fakultetit të Shkencave Teknike, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", në bashkëpunim me Departamentin e Informatikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Departamentin e Informatikës, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Departamentin e Matematikës dhe Informatikës nga Universiteti i Gjirokastrës "Eqerem Cabej". Konferenca arriti të mbledhë sëbashku kërkues, studiues, akademik, inxhinier, studentë të cilët me prezantimet e tyre bënë të njohur rezultatet më të fundit kërkimore dhe ndan përvojat dhe idetë më të reja në fushën e shkencave kompjuterike dhe të teknologjisë së informacionit.

2. Seminari më temë "Internet of Everthing".

Qëllimi i seminarit ishte nxitja dhe inkurajimi i studentëve drejt punës kërkimore në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi me njëri-tjetrin si dhe aftësimi për të prezantuar punimet e tyre. Në këtë seminar referuan studentët e Shkencave Kompjuterike të nivelit Bachelor dhe Master.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

3. Seminare shkencore

Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike zhvillohen seminare shkencore, anëtare të stafit akademik referojnë mbi tema të caktuara mbi fusha të ndryshme studimi. Pjesë e këtyre seminare janë edhe studentët në nivel Bachelor dhe Master.

4. Aktivitete sociale

Stafi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është pjesë e aktiviteteve sociale dhe kontributeve të vazhdueshme në ndihmë të fëmijëve në nevojë. Në aktivitetet sociale janë përfshirë edhe studentët me ndihmën dhe praninë e tyre.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

5. Staf i akademik, ndihmës akademik, studentët në DSHK

Departamenti i Shkencave Kompjuterike i cili mbulon diplomat : Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Bachelor në Informatikë, Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Bachelor në Teknologji Informacioni, "Master Profesional" në Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë, dhe "Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike" është pjesë e departamenteve të Fakultetit të Shkencave Teknike. Për një cilësi në rritje, ka qënë në fokus të punës individuale të secilit antar të stafit akademik të departamentit kualifikimi i mëtjeshëm. Aktualisht pjese e departament janë 11 pedagoge me kohë të plotë, 2 të ftuar dhe 4 pedagogë me kohë të pjesshme. Katër pedagoge kanë marrë gradën shkencore "Doktor" dhe dy janë duke ndjekur studimet e ciklit te trete. Staf i përbërës akademik dhe ndihmës akademik është si më poshtë:

Titulli dhe Emri	Grupi mësimor	Pozicioni Akademik
Dr. Eljona Proko	Programim dhe Zhvillim Software	Përgjegjëse e departamentit, lektore e lëndëve: Programin në C++, Programim në Java, Programim dhe Zhvillim Web, Struktura e gjuhëve të Programimit
Dr. Alketa Hyso	Sisteme Kompjuterike	Lektore e lëndëve: Baza të Dhënash, Inteligjence Artificiale, Arkitekturë Kompjuteri e Avancuar, Sisteme Operative, Sisteme te Menaxhimit te Bazave te te Dhenave
Dr. Dezdemonia Gjylapi	Programim dhe Zhvillim Software	Lektore e lëndëve: Strukturë të Dhënash, Didaktika e Informatikës, MatLAB, Hyrje në Programim, Algoritmikë dhe Strukturë të të Dhënave e Avancuar
Dr. Roneda Mucaj	Programim dhe Zhvillim Software	Lektore e lëndëve: Projektimi dhe Analiza e Algoritmave, Hyrje ne Inteligjencen Artificiale, Praktike ne Mesimedhenie



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

MSc. Alma Sheko	Programim dhe Zhvillim Software	Lektore e lëndëve: Programim Web, Hyrje ne Rrjetat Kompjuterike,
MSc. Besnik Mehmeti	Sisteme Kompjuterike	Lektor i lëndëve: Siguria e Sistemeve Kompjuterike, Inxhinieri Software, TIK ne Ekonomi
MSc. Medrit Mustafaraj	Sisteme Kompjuterike	Lektor i lëndëve: Teknologjia dhe Multimedia Interaktive, Arkitekture Kompjuteri, TIK gjuhet e huaja
Msc. Fjoralba Sota	Sisteme Kompjuterike	Lektore e lëndëve: Hyrje ne Programim, Telekomunikacion
Msc. Romina Agaci	Programim dhe Zhvillim Software	Lektore e lëndëve: Sistemet te Menaxhimit te Informacionit, Didaktika e Programacionit
MSc. Nirida Pashaj	Programim dhe Zhvillim Software	Lektore e lëndëve: Sisteme Informacioni ne Ekonomi, Hyrje ne Informatike
MSc. Eljona Zanaj	Sisteme Kompjuterike	Hyrje ne Programim, Sisteme Elektronike dhe Rrjeta Logjike, TIK
MSc. Indrit Memaj		Ndihmës akademik, laborant
MSc. Miranda Pajo		Sekretare

Studentët

Stafi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike synon t'i pajisë studentët me të menduarin dhe të punuarin bashkëkohor me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për të arritur sukses në edukimin e studentëve do të synojmë:

- Mësimdhënie kreative me metoda bashkohore.
- Nivel të lartë të përkrahjes për avancim personal.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

- Mundësi pjesëmarrje në organizime të ndryshme të mësimit, hulumtimit dhe punës në praktikë.
- Kualitet i lartë mësimdhënës, ambjent dhe akomodim social, duke i angazhuar në jetë sociale dhe kulturore.
- Forcimit të lidhjeve me tregun e punës dhe të mbështetjes së studentët në punësim.
- Vendosi se lidhjeve me tregun e punës që përpara diplomimit
- Të tërheqim grupe të studentëve përmes metodave fleksible për kualifikime të mëtejshme profesionale dhe shkencore, duke krijuar partneritet strategjik me institucionet e tjera të edukimit në vend dhe jashtë dhe alternativa shtesë për edukim adekuat.
- Fokusi duhet të drejtohet në tërheqjen e studentëve, mbajtjen e studentëve, duke siguruar zhvillimin e cilësisë në mënyrë të vazhdueshme.
- Një parakusht për rritjen e departamentit është rritja e numrit të studentëve, dhe përfundimi i studimeve nga studentet brenda afatit kohor.

6. Gjendja Aktuale në Departamentin e Shkencave Kompjuterike

- Infrastruktura fizike në funksion të mësimdhënies

Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike një rol kryesor në zhvillimin e procesit mësimor dhe trasmetimin e njohurive luajnë laboratorët. Aktualisht departamenti ka në dispozicion dy laboratore. Është kërkuar ngritja e një laboratorit të ri ku kompjuterat të kenë kapacitet për të punuar dhe suportuar programet e nevojshme për zhvillimin e lëndëve që ofrohen në planet e ciklet të parë dhe të dytë të studimit. Për ngritjen e laboratorit të ri po punohet nga një grup pune i caktuar nga administratorja e Universitetit. Një boshllëk krijon mungesa e Bibliotekës në ambientet e Departamentit të Shkencave Kompjuterike.

- Planet dhe programet avantazhet, disavantazhet

Kurrikula në shkencat kompjuterike përballet me presionin e vazhdueshëm për të integruar zhvillime të reja kritike. Ndryshimet në teknologji, ndikojnë gjithashtu në procesin e edukimit. Me këtë ritëm ndryshimi në teknologjinë e kompjuterave, programet aktuale në nivel Bachelor dhe Master ka nevojë për ndryshime për t'iu përgjigjur këtij realiteti të ri dhe dinamik. Një element i rëndësishëm që mungon në planet aktuale të ofruara nga departamenti është praktika



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

mësimore. DSHK synon përmirësime të vazhdueshme të planeve dhe programeve mësimore, duke i përshtatur në vazhdimësi me kërkesat e kohës dhe ekonomisë së tregut. Ndryshimet e reja në program, i japin një peshë më të madhe punës individuale krijuese, apo projekteve në grup, me qëllim përgatjen e kërkuesve produktive në fushën e shkencave kompjuterike për të ardhmen. Fokusi është në zhvillimin e cilësisë së programeve të studimit të departamentit në mënyrë që të jemi sa më të konkurrenshëm dhe me një nivelin akademik çilesor. Po punohet për riorganizimin e programeve në nivel Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni dhe Informatikë, si dhe në nivel Master në Shkenca dhe Master Profesional në Mësuesi sipas ligjit të Arsimit të Lartë. Njëpërmjet praktikës mundësojmë që studentët të përdorin njohuritë e fituara në kurset teorike në një kontekst praktik dhe profesional; të fitojnë eksperiencë dhe t'u ofrojmë mundësi për punësim të mëtejshëm. Studentëve që kanë aspirata për të zhvilluar kërkimin shkencor, do t'u jepet mundësia për të marrë pjesë në grupet kërkimore, pjesë e projekteve shkencore në departament apo fakultet.

- Cilësia e diplomave të lëshuara, sa efektive kanë rezultuar në tregun e punës.

Në përfundim të programit mësimor studentët do të jenë të pajisur me të gjitha njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike që të krijojnë projekte të mëdha dhe të vogla, të ndërtojnë dhe mirëmbajnë sisteme dhe rrjeta kompjuterike, në çdo kompani brenda apo jashtë vendit, si dhe mund të vazhdojnë studimet e ciklit të tretë të doktoraturës në fushën e shkencave kompjuterike.

Çdo vend pune, kërkon aftësi në përdorimin e teknologjise. Sa më shumë përdoret teknologjia, aq më shumë ekspertizë kërkohet për sfida më të mëdha. Bizneset kërkojnë gjithnjë e më shumë zgjidhje teknologjike specifike të përshtatura me nevojat e tyre dhe nevojat e konsumatorëve. Keto kërkesa të tregut të punës janë përmbushur me se miri dhe do të vazhdojnë të përmbushen në të ardhmen nga studentet e diplomuar në Departamenti e Shkencave Kompjuterike. Diplomat e lëshuara kanë rezultuar tepër efektive duke u punësuar të diplomuarit në sektor të ndryshëm si:

Specialistë informatike në administratën publike dhe lokale.

Programues pranë kompanive të zhvillimeve Softuerike

Specialiste informatike pranë Bankave dhe Kompanive të tjera Financiare



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Specialistë IT pranë kompanive ISP

Specialistë IT pranë kompanive që ofrojnë shërbime ICT

Mësues të informatikës në arsimin parauniversitar te aftë për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit të teknologjisë së informacionit.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

7. Analiza SWOT e Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Pikat e Forta

1. Cilësi dhe përkushtim në mësimdhënie
2. Staf akademik me kohë të plotë i kualifikuar
3. Staf mbështetës në mësimdhënie.
4. Cilësi e lartë e kurrikulave të ofruara për programet e studimit bazuar në modelin amerikan
5. Angazhim i stafit akademik në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare
6. Përdorimi i teknologjisë modern në procesin e mësimdhënies
7. Vlerësim i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët
8. Informatizimi i sistemit në funksion të informimit të studentëve
9. Bashkëpunim me universitetet brenda dhe jashtë vendit

Pikat e Dobëta

1. Mungesa e hapsirave për ngritjen e laboratorëve
2. Pjesëmarrje e vogël në projekte ndërkombëtare
3. Cilësi e ulët e një pjese të madhe të studentëve në hyrje
4. Pjesëmarrje e paktë e studentëve në projekte rajonale
5. Mungesa e ciklit të tretë të studimeve

Oportunitetet

1. Zhvillimi i politikave për rekrutim të studentëve cilësorë
2. Përmirësim i infrastrukturës ekzistuese
3. Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare
4. Mobilitet në staf dhe studentë
5. Bashkëpunime dhe marreveshje me universitete dhe partner



**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

Risqet

1. Numri i madh i institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë programe studimi në Shkenca Kompjuterike dhe të ngjashme me të
2. Largimi i studentëve cilësor jashtë vendit
3. Burime të kufizuara për të rekrutuar personel akademik me tituj dhe grada shkencore
4. Infrastrukturë e kufizuar në dispozicion të departamentit

8. Shërbimet ndaj të tretëve/komunitetit

Një rëndësi të veçantë në departamentin e Shkencave kompjuterike i kushtohet kontributit që mund të jap departamenti, studentët dhe stafi akademik në shërbim të komunitetit. Stafi akademik i departamentit ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në trajnime që u janë bërë mësuesëve të shkollave publike të rrethit të Vlorës dhe të qyteteve të tjera të vendit, në zbatim edhe të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim" të mundësuar nga MASH. Studentët kanë dhënë kontributin e tyre në shërbim të komunitetit duke marrë pjesë aktivisht në evenimente (seminare, konferenca) të ndryshme.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

9. Kuadri Strategjik

Udhëzuesit strategjik

Në përmbushje të vizionit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, planifikohet **startegjia afatshkurtër si më poshtë:**

- Rekrutimi i stafit të talentuar është një element kyç për të siguruar një cilësi të lartë në mësimdhënie dhe nivel në kërkimin shkencor. Synimi ynë është integrimi si pjesë e stafit akademik të kërkuesve apo të diplomuarve shkëlqyeshëm në institucionet perëndimore.
- Funksionimi i grupeve mësimore për përmirësimin e programeve mësimore sipas udhëzimeve të MASR, për të qenë më pranë kurrikulave korresponduese të institucioneve homologë perëndimorë.
- Përditësimi dhe pasurimi i faqeve web ekzistuese, të moduleve të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike.
- Studimi në vazhdimësi i tendencave të tregut dhe të zhvillimit të ekonomisë për të përshatur programet ekzistuese të studimit, apo për të hapur programe të reja.
- Aplikimi së shpejti për hapjen e programeve të reja të studimit 2-vjeçar profesional në "Teknik rrjetash dhe sistemesh kompjuterike" dhe "Zhvillues Web-i".
- Trajnime të vazhdueshme të stafit akademik në lidhje me metodat dhe teknologjitë e reja në mësimdhënie për modernizimin e orës së mësimi.
- Rekrutimi i studentëve cilësor. Do të vazhdohet të punohet nëpërmjet politikave të marketingut që institucioni dhe DSHK bëjnë pranë shkollave të mesme të rajonit, për të tërhequr studentë cilësorë.
- Nxitja e aktiviteteve sportive dhe kulturore për studentët dhe komunitetin lokal.
- Organizimi i konferencës NRA-CSIT në mënyrë periodike, duke sjellë bashkëpunimin shkencor me departamentet homologe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës dhe atë të Universitetit të Elbasanit.
- Nxitja dhe mbështetja e punës individuale të anëtarëve të stafit në kualifikimin e tyre në ciklin e tretë të studimeve dhe marrjen e titujve akademik.



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

- Organizimi i vazhdueshëm i seminareve shkencore me fokus pjesëmarrjen e studentëve të të dy cikleve të studimit.
- Aplikimin në projektet kërkimore-shkencore multidisiplinar, mbështetur në partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar.
- DSHK do të vazhdojë të konsolidojë marrëdhëniet e krijuara me partnerët e vet në planin kombëtar apo ndërkombëtar, nëpërmjet konferencave, simpoziumeve, Workshope-ve, projekteve të përbashkëta, etj.
- Lidhjen e marrveshjeve me institucione arsimore, institucione shtetërore dhe biznese private, me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të të dy cikleve të studimit në departamentin e Shkencave Kompjuterike.

Në përmbushje të vizionit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, planifikohet **strategjia afatmesme si më poshtë:**

- Pasurimi i vazhdueshëm dhe rritja e cilësisë së bazës didaktike dhe laboratorëve mësimor.
- Krijimi i kurseve online apo ndarja e punës në cloud, për nxënës të shkollave të mesme, të cilët mund të përftojnë një eksperiencë në programim përpara se të zgjedhin degën ku do të studjojnë, për studentët aktualë dhe të diplomuar, mësues, apo specialistë IT.
- Ngritja e strukturës vullnetare të mentorimit, të përbërë nga studentë të vitit të fundit të ciklit Bachelor ose studentë të ciklit Master të studimit, për të përmirësuar nivelin e shërbimeve të këshillimit dhe konsultimit akademik të studentëve.
- Zhvillimi i një sistemi informacioni për dokumentimin dhe menaxhimin e aktiviteteve kërkimore.
- Angazhim i vazhdueshëm në kërkime me partnerët dhe industrinë, për përfitimin e fondeve drejt mbështetjes së aktiviteteve kërkimore si seminare, workshop-e, konferenca, botime dhe projekteve të përbashkëta.
- Ofrimi i shërbimeve ndaj të tretëve, duke përfshirë konsulencë për qeverisjen lokale, komunitetin, industrinë dhe publikun e gjerë.

Në përmbushje të vizionit të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, planifikohet **strategjia afatgjatë si më poshtë:**



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

- Rritja e nismave globale nëpërmjet organizimit të konferencave dhe workshop-eve ndërkombëtare
- Tërheqja e studentëve ndërkombëtarë si një mundësi për ekspozim ndërkombëtar të departamentit.
- Rekrutimi i stafit ndërkombëtar për të sjellë një perspektivë globale në departament.
- Hapja e programeve të ciklit të tretë të studimit në fushën e Shkencave Kompjuterike.
- Në kuadër të kërkimit shkencor synojmë përmirësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, nëpërmjet ngritjes së bibliotekës të departamentit, laboratorëve shkencorë dhe sallave të workshope-ve, për të nxitur dhe përmirësuar kërkimin shkencor të anëtareve të stafit akademik, duke kontribuar me produkte konkrete dhe me impakt në rajon.
- Botimin e rregullt online të revistës së departamentit, "NRA-CSIT Journal", me një frekuencë 6-mujore.
- Patentimi i rezultateve të hulumtimit me qëllim komercializimin i tyre.
- Ngritja e skemës së bursave për studentët cilësor dhe ata në nevojë.

MIRATOI

Përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Kompjuterike

Dr. Eljona PROKO